



Prishtinë, 10.07.2025
Kodi i ZRRE-së: V_2795_2025

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRrE/DMK_V_2711_05_25** i datës 26.05.2025;
- Kundërshtimi i KESCO-s i datës 26.06.2025.

në seancën e mbajtur më datë 10.07.2025 nxori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET** Kundërshtimi i KESCO-s, ndaj Vendimit të DMK-së për konsumatorin B. L., me shifër DPR - 90148999, si i pabazuar.
- II. MBETET** në fuqi, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK_V_2711_05_25 i datës 26.05.2025.
- III.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 66.05.2025 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK_V_2711_05_25 me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e konsumatorit B. L., dhe e ka obliguar KESCO-n që të anulohet taksën e shkyçjes së dt. 24.03.2025, në vlerë prej 17.70 €.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, Furnizuesi KESCO, brenda afatit ligjor ka paraqitur Kundërshtim në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- Konsumatori është shkyçur për shkak që ka pasur borxh të papaguar dhe nuk ka realizuar pagesa tjera për faturat e tjera të pa kontestuara.
- Për faturën 12/2024 në vlerë prej 147.60 €, e ka realizuar pagesën prej 30 €, kurse më pastaj pas pranimit të faturës 01/2025 nuk ka realizuar pagesa të tjera.
- Duke iu referuar dispozitave ligjore të Rregullës për Shkyçjen dhe Rikycjen e Konsumatorëve, konsumatori është i obliguar që të paguaj pjesën e pakontestuar të faturave për të cilat ka parashtruar ankesë dhe i njëjti nuk ka realizuar asnjë pagesë pas faturës 01/2025, 02/2025 dhe 03/2025 dhe nuk ka realizuar pagesë të faturave sipas mesatares së faturave gjatë tre (3) muajve të mëparshëm.
- Departamenti për konsumatorë në KESCO, kërkon nga Bordi i ZRrE-së, pezullimin e Vendimit të DMK-së me nr. ZRrE/DMK_V_2711_05_25 i dt. 26.05.2025



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 10.07.2025 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka administruar këto prova: Kundërshtimin e KESCO-s të datës 26.06.2025; Vendimin e DMK-së të datës 26.05.2025; Vendimin e KESCO-s të datës 13.02.2024; Kërkesat e konsumatorit në KESCO; Ankesën e konsumatorit në DMK të ZRrE-së të datës 26.02.2025; Transaksionet e konsumatorit, Rrjedhën e energjisë dhe Listat e Leximit.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se Kundërshtimi i KESCO-s **është i pabazuar**, sepse:

Në vështrim kronologjik të këtij rasti, Bordi ka gjetur se, me datë 03.01.2025, Departamenti i Faturimit në KESCO i ka dërguar konsumatorit faturën mujore me nr. 12240DPR – 90148999 në vlerë prej 136.17 €, me gjendje të shpenzimeve prej TL = 835.9 kWh dhe TU = 548.94 kWh apo në total prej **1384.84 kWh**. I pakënaqur me këtë faturë, konsumatori ka parashtruar ankesë në KESCO, duke e kontestuar të njëjtën, nën dyshimet për faturim jo të saktë të energjisë elektrike me njehsorin elektrik me nr. 43623139, me arsyetimin se, konsumatori gjatë kësaj periudhe nuk ka qenë në Kosovë.

Pas shqyrtimit dhe analizimit të ankesës së konsumatorit, Departamenti për Kujdes ndaj Konsumatorëve në KESCO, me datë 13.02.2025 ka nxjerrë një Vendim, me të cilin refuzohet ankesa e konsumatorit dhe atë duke u bazuar në Lista të leximit, Rrjedhë të Energjisë Elektrike dhe Transaksionet, me arsyetimin se, njehsori është lexuar me rregull dhe nuk është evidentuar asnjë parregullsi në këtë pikë matëse.

Me datë 26.02.2025, i pakënaqur me këtë Përgjigje, konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, duke i kontestuar faturat e muajve 12/2024 dhe 01-02/2025. Konsumatori i propozon DMK-së që ankesa të aprovohet, ashtu që faturat e kontestuar të rishqyrtohen, sipas shpenzimit real të konsumatorit, të anulohet taksa e shqyrcjes në vlerë prej 17.70 EUR, të kërkohet dokumentacioni adekuat për verifikimin e gjendjes së njehsorit apo të leximit dhe të gjëbjetet KESCO-ja për maltretimet e shkaktuara konsumatorit.

Bazuar në analizën e përgjithshme që i është bërë Transaksioneve, Rrjedhës së Energjisë Elektrike dhe Listave të Leximit, vihet re që, konsumatori është kyçur në rrjetin e energjisë elektrike që nga dt. 16.07.2020, për çka konsumatori ishte ngarkuar me taksën e kyçjes në vlerë prej 118 €. Duhet theksuar se, konsumatorit i ishte ndërruar njehsori në muajin 01/2021, ashtu që, nga matja ishte larguar njehsori me nr. 75162643 dhe për matje ishte vendosur një njehsor i ri me nr. 43523139. Po ashtu, vihet re që, konsumatori është lexuar dhe është faturuar me rregull dhe nuk është evidentuar asnjë parregullsi në këtë pikë matëse të konsumatorit. Konsumatori e ka të vendosur njehsorin e llojit SMART dhe i njëjti lexohet nga distanca.

Më tej, Bordi i ka analizuar me kujdes shpenzimet e konsumatorit para dhe pas periudhës kontestuese, dhe ka gjetur se, këto shpenzime janë si vijon: muaji 11/2024 është **1861.73 kWh**, muaji 12/2024 është **1384.84 kWh**, muaji 01/2025 është **1641.98 kWh**. Më tutje, shpenzimet e konsumatorit të një viti më



parë janë si në vijim: muaji 11/2023 është **229.74 kWh**, muaji 12/2023 është **1506.08 kWh**, muaji 01/2024 është **4292.96 kWh**. Shpenzime të përafërta konsumatori ka pasur edhe në vitin paraprak, si në vijim: muaji 11/2022 është **1951.7 kWh**, muaji 12/2022 është **3441.96 kWh**, muaji 01/2023 është **3635 kWh**. Pra, nga sa mund të shihet, konsumatori ka shpenzime të ngjashme në periudhën dimërore edhe në vitet e kaluara. Andaj, duke qenë se, nuk është evidentuar asnjë parregullsi në këtë pikë matëse, konsumatori është lexuar dhe është faturuar me rregull, pas kontrollimit të njehsorit ka rezultuar në rregull dhe brenda kufijve të lejuar të matjes, dhe se shpenzimet e konsumatorit janë të përafërta në këtë periudhë kohore edhe në vitet e kaluara, Bordit gjeti se, DMK me të drejtë ka vendosur që ta refuzoj këtë ankesë si të pabazuar.

Bordi më tej i analizoi me kujdes edhe Transaksionet e konsumatorit dhe ka gjetur se, konsumatori me dt. 24.02.2025 është shkyçur nga rrjeti i energjisë elektrike, për shkak të borxhit të papaguar në vlerë prej 246.03 €, përfshirë këtu faturën e kontestuar të muajit 12/2024 dhe faturën e muajit 01/2025. Përkundër parashtrimit të ankesës nga konsumatori, sipas legjislacionit në fuqi, konsumatori është i obliguar që të bëjë një pjesë të pagesës së kësaj fature, gjë që në rastin konkret nuk ka ndodhur. Një zgjidhje e tillë ligjore është e përcaktuar në nenin 17 – Kundërshtimi dhe Shqyrtimi përpara shkyçjes, të Rregullës për Shkyçjen dhe Rikyçjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë, si në vijim: *“Nëse objekt i ankesës/kontestit bëhet një faturë, ndërmarrja e energjisë nuk do ta shkyçë konsumatorin në bazë të mospagesës së shumës së plotë të faturës së tillë, derisa ndërmarrja e energjisë dhe/ose Rregullatori ta ketë shqyrtuar dhe të ketë lëshuar një vendim në lidhje me saktësinë e kësaj fature. Derisa të bëhet rishikimi dhe marrja e vendimit, **nga konsumatori do të kërkohej të paguajë pjesën e faturës që është e pakontestuar. Pjesa e faturës së pakontestuar do të paguhet bazuar në mesataren e faturave gjatë tre (3) muajve të mëparshëm**”*. DMK më tej ka gjetur se, konsumatori është shkyçur për të dytën herë, me datë 24.03.2025, përkundër që e kishte bërë një pjesë të pagesës së borxhit të kontestuar dhe atë me datë 26.02.2025, në vlerë prej 30 €. Gjithsesi, duke qenë se, konsumatori e kishte paguar një pjesë të borxhit të pakontestuar dhe se konsumatori e ka pasur ankesën në proces, DMK me të drejtë ka vendosur që ta anuloj taksën e shkyçjes në vlerë prej 17.70 €, të dt. 24.03.2025.

Bordi po ashtu thekson se, duke u bazuar në nenin 28 – Faturimi, të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji e ku thuhet se: 1. *Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar edhe për tarifat tjera, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme) dhe 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit universal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit, Furnizuesi KESCO ka vepruar në harmoni me rregullativën ligjore në fuqi.*

Tutje, duke u bazuar në nenin 5 – Furnizimi me Energji elektrike – të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike, *“të gjithë konsumatorët e kanë për obligim që të paguajnë për energjinë elektrike të shfrytëzuar sipas kontratës për furnizim me energji të lidhur me furnizuesin e energjisë, si dhe për tarifat për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRrE-ja”*, andaj konsumatorja e ka për obligim që të paguaj energjinë elektrike të cilën e ka shpenzuar.



Bordi i ZRrE, gjithashtu ka konstatuar se i licencuari KESCO në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova konkrete.

Bordi i ZRRE pas analizave të bëra dëshmime dhe argumenteve të paraqitura nga palët si dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, Rregullën për Shkyçjen, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO-s;
- Konsumatorit **B. L.**;
- Arkivit të ZRrE-së.